



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA JURIDIKE DHE E BURIMEVE NJERËZORE

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE
PËR PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

(Specialist)

**Lloji i diplomës “Inxhinieri Ndërtimi”, “Urbanist”, “Arkitekt”
Niveli minimal i diplomës “Diplome e Nivelit te Pare”**

Në zbatim të Nenit 22 dhe të Nenit 25, të Ligjit 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” i ndryshuar, VKM-së Nr.142 datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” i ndryshuar ; si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, **Bashkia Roskovec** shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për grupin e pozicioneve:

❖ 1(nje) specialist Inxhinier Ndertimi, Urbanist, Arkitekt, ne Bashkine Roskovec
Kategoria e pages IV-A (IV.1)

Shpallja eshte e hapur per te gjithë nepunesit civil te se njejtës kategori ne te gjitha institucionet pjese e shërbimit civil.Nese nuk ka nje fitues nga procedura e levizjes paralele, plotesimi i vendit vakant do te realizohet me procedurën e Pranimit në shërbimin Civil.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe Pranimi ne Shërbimin Civil në kategorine ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- **Afati për dorëzimin e dokumentave për**

LEVIZJE PARALELE: 13/10/2017

- **Afati për dorëzimin e dokumentave për**

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: 18/10/2017

Përshkrim i Përgjithshëm

Planifikimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit nëpërmjet përdorimit racional të tokës. Misioni Lehtësimi i realizimit të objektivave politikë dhe interesave për zhvillim, nëpërmjet identifikimit të potencialeve dhe planifikimit të qëndrueshëm të territorit. Implementimi, monitorimi dhe përditësimi i planit të përgjithshëm vendor dhe planeve te ndryshme sektoriale dhe ndërsektoriale. Shqyrtimi e vlerësimi i kërkesave për lejimin e kryerjes së punimeve për zhvillimin e tokës ose të strukturës në të, deri në

vendimarrje , në përputhje me përcaktimet e detyrueshme të politikave të hartuara, planeve e rregulloreve të miratuara dhe legjislacionit në fuqi.

DETYRAT

Detyrat Kryesore

- *Realizon punimet topografike te objekteve ne studim, duke bere azhornimet perkatese.*
- *Kontrollon plan piketimin dhe kuotimin e objekteve te miratuara.*
- *Shqyrton ankesat e qytetarëve.*
- *Trajton nga ana kadastrale dosje për leje ndërtimi.*
- *Trajton një pjesë të genplaneve të azhornimit dhe kontrolleve në objekte, nga pikepamja topografike.*
- *ashkepunon me sektoret e tjere te drejtorise per problemet e hasuara gjate punes.*
- *Zbaton te gjitha detyrat e dhena nga drejtori per problemet qe dalin brenda natyres se punes se tij.*

I. Levizja Paralele

Kjo procedurë është e hapur vetëm për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

Kushtet minimale që duhet të plotësojnë kandidatët për lëvizjen paralele janë:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda të njëjtës kategori.
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
3. Të ketë të paktën vlerësim e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”.

Kriteret e vecanta per kete pozicion jane:

- a) Te zoteroje diplome minimumi 3-vjecare, Diplomë “Bachelor”.Nese diploma eshte marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi,
- b) Te kete te pakten 1 vit punë,
- c) Te kete njohuri te një gjuhe te huaj;

Kandidati duhet të dërgojë **me postë ose dorazi në një zarf** të mbyllur, në zyrën e Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovec, këto dokumenta:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
2. Një kopje të jetëshkrimit (CV).
3. Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
4. Fotokopje e diplomës.Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
5. Fotokopje e diplomës me listën e notave.Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
6. Fotokopje e vleresimit të fundit vjetor.
7. Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
8. Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
9. Fotokopje e letërnjoftimit (karte Identiteti).

10. Vërtetim të gjëndjes gjyqësore dhe shëndetsore.(Deshmi penaliteti dhe raport mjekesor).

Dokumentet e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë 13.10.2017 .

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së levizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në datën **16.10.2017** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në :

- portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit",
- në faqen zyrtare të Internetit të Bashkisë
- në stendën e informimit të publikut.

Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen individualisht nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, për shkaqet e moskualifikimit në të njëjtën ditë me shpalljen e listës së verifikimit paraprak të kandidatëve.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësine përgjegjëse të menaxhimit të Burimeve Njërëzore, brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes së saj.

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambientet e Bashkisë Roskovec më datë **26.10.2017 ora 10:00**.

Në intervistë kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar nga ligji nr. nr. 73/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar nga ligji nr. ligjin Nr. 9200, datë 26.02.2004, ligji nr. 9794, datë 23.07.2007, ligji nr. 9826, datë 01.11.2007, ligji nr. 10 137, datë 11.05.2009, ligji nr. 10 324 datë 23.09.2010, ligji nr. 11/2012 datë 09.02.2012 dhe ligji nr. 20/2013 datë 14.2.2013; Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit" i ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010, ligji nr. 23/2013 datë 14.2.2013 dhe ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:

Kandidatët do të vlerësohen nga **Komisioni i Brendshëm për Lëvizjen Paralele i ngritur në Bashkinë Roskovec**, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është **100 pikë**, të cilat ndahen përkatësisht:

- a. **40 pikë** për dokumentacionin e dorëzuar i ndarë: 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, 10 pikë për çertifikimin

pozitiv ose per vleresimet e rezultateve me pune , ne rastet kur procesi I certifikimit nuk eshte kryer;

b. **60 pikë** për intervistën me gojë;

Komisioni, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve) në rast të kandidatëve me pikë të barabarta, zbatohet parashikimi i pikës 13, të Kreut IV të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242 dt.18.03.2015 ‘Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese’.

Komisioni më date **27.10.2017** njofton për vendimin e përzgjedhjes, Njesine Pergjegjese te Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia Pergjegjese e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, me date **30.10.2017** shpall fituesin.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” ,
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- stenden e publikimeve te Bashkisë Roskovec.

II- Pranimi në Shërbimin Civil.

Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele nuk ka fitues, plotësimi i vendit vakant do të realizohet nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar:

Kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotrojnë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë dënues me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar (hequr) sipas këtij ligji.

Kriteret e veçanta për këtë pozicion janë:

- Te zoteroje diplome 3-vjecare, “Bachelor” ne deget : "Inxhinjeri Ndertimi, ".Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidati duhet të dërgojë me postë ose dorazi në një zarf të mbyllur, në zyrën e Drejtorise Juridike dhe Burimeve Njërëzore, të Bashkisë Roskovec këto dokumenta:

- Letër motivimi për aplikim në vendin vakant.
- Një kopje të jetëshkrimit.
- Nje numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit.
- Fotokopje e diplomës. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj duhet ta ketë të njesuar pranë Ministrisë së Arsimit.
- Fotokopje e diplomës me listën e notave. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar.
- Fotokopje të librezës së punës e plotësuar.
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme.
- Fotokopje e letërnjoftimit.
- Vërtetim gjëndjes gjyqësore dhe shëndetësore.

Dokumentat e mësipërme duhet të dorëzohen deri më datë 18.10.2017.

Rezultatet nga verifikimi paraprak të kushteve minimale të procedurës së pranimit në shërbimin civil dhe të përmbushjes së kriterëve specifikë të vendit të punës do të dalin në

daten **30.10.2017** nëpërmjet shpalljes së listës emërore të kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin, në portalin "Shërbimi Kombëtar i Punësimit", në faqen e Internetit të Bashkisë dhe në stendën e informimit të publikut.

Gjithashtu, po në këtë datë kandidatët që nuk janë kualifikuar do të njoftohen nga Njesia Përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njërëzore, për shkak të moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njesinë Përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njërëzore brenda 5 ditëve kalendarike nga dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve pune nga data e depozitimit të saj.

Konkurimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë, do të zhvillohet në ambjentet e Bashkisë Roskovec më datë **15.11.2017** ora **10:00**.

Në konkurimin me shkrim dhe intervistë e strukturuar me gojë, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë e tyre në këto fusha:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar nga ligji nr. nr. 73/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107/2014 "për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinën e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar nga ligji nr. ligjin Nr. 9200, datë 26.02.2004, ligji nr. 9794, datë 23.07.2007, ligji nr. 9826, datë 01.11.2007, ligji nr. 10 137, datë

- 11.05.2009, ligji nr. 10 324 datë 23.09.2010, ligji nr. 11/2012 datë 09.02.2012 dhe ligji nr. 20/2013 datë 14.2.2013;
- Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010, ligji nr. 23/2013 datë 14.2.2013 dhe ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;
 - Si dhe akte nenligjore ne zbatim te ketyre ligjeve.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen nga Komisioni i Përhershëm i Pranimit, i ngritur pranë Bashkisë Roskovec.

Totali i pikeve te vleresimit te kandidateve eshte 100 pike te cilat ndahen perkatesisht:

- a. 15 pike për dokumentacionin e dorëzuar;
- b. 25 pikë për intervistën e strukturuar me gojë;
- c. 60 pikë për vlerësimin me shkrim.

Komiteti i Përhershëm i Pranimit, në përfundim të vlerësimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari me pikët maksimale, për t'u emëruar në pozicionin “*Specialistit I Finances*”.

Në rast se dalin fitues më shumë se një kandidat, me pikë të barabarta, zbatohen parashikimet e pikës 13, të kreut IV, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë, 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorin ekzekutive”.

Komiteti i Përhershëm i Pranimi brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pra më date **16.11.2017** I ve ne dispozicion listen e fituesve, Njesise se Menaxhimit te Burimeve Njerezore.

Njesia e Menaxhimit te Burimeve Njerezore, me date **17.11.2017** shpall listen e fituesve.

Njoftimi do të bëhet:

- në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”
- në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec
- ne stenden e informimit publik te Bashkise Roskovec.

Per sqarime te metejshme mund te kontaktoni ne :

e-mail : evisa.mustafaj@yahoo.com

nr.tel: **0387 80242.**

NJESIA E MENAXHIMIT TE BURIMEVE NJEREZORE

BASHKIA ROSKOVEC